Republika e Kosovës – .Republic of Kosova
Komuna Hani i Elezit - Municipality of Elez Han

01Nr 2201 /2024
19.03.2024

Në bazë të Ligjit për ndërrmarrjet publike 03/L-087,nenit 8 ligji Nr. 03/L-212 të Punës dhe vendimit të Qeverisë Nr. 09/104 datë 10.08.2016 për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, Komisioni Komunale i Aksionarëve, të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave në Hanin e Elezit, shpallë:

# KONKURS

**Për një (1) pozitë me kohë të caktuar për antar të Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale për menaxhimin e mbeturinave NPL "Pastrimi "në Hani të Elezit.**

## KUALIFIKIMI DHE PERGATITJA PROFESIONALE

**Bazuar në nenin 17 të ligjit për ndermarrjet publike nr. 03/l-087 kandidati për antar të bordit të ndërmarrjes publike lokale duhet të ketë kualifikim dhe përvojën e punës si në vijim:**

- të ketë pergatitje universitare te nevojshme
- të posedoj aftesi dhe shkathtesi profesionale per te punuar ne menyre te suksesshme ne shoqeri multietnike
- të ketë aftesi per te kryer detyrat e punës në situatë të qetë dhe nën presion

## KUSHTET

**Kandidati ka te drejte te zgjidhet ne Bordin e Ndërrmarrjes Publike Lokale nëse :**

- nuk ka qenë I denuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- nuk ka shkelur kodin etik apo standartet e sjelljes profesionale, për veç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organë tjetër i ankesave;
- nuk ka bërë përgënjështrime materiale nën çëfardo dëshmie nën betim;
- nuk ka qenë në post menagjues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë(10) vjetëv e të fundit.
- nuk punone në ndonjë instutucionë ku bëhen politikat zhvillimore Ndërrmarrjeve Publike ku kandidati aplikon.

**Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale nëse:**

- aktualisht është zyrtar, menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, ose cilësdo nga filialet e saj;
- ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj brenda pesë(5) vjetëve të kaluara;
- aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfardo mardhënie material afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo filialet e saj, qoftë në mënyr të drejtëpërdrejt ose të tërthort;
- është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjeter juridik, i cili ka marredënie material afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;

- pranon, ose ka pranuar mbrenda tre(3) vjetëve të kaluara , kompensimi shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj(përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulus të përcaktuar në nenit 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj;
- përfaqëson një ankionar i cili posedon mbi dhjetë për qind(10%) të aksioneve votuese në •Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- ka shërbyer në Bordin prej Drejtorive të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë(9) vjetë nga data e zgjedhjes së pare të tij/saj;
- është i afërm i shkollës së tretë(siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e ''Interesit Financiar'' në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike) i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategorit e sipërpermendura.
- është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkuron me Ndërmarrjen ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind(2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqërit tregtare që konkurojn me Ndërmarrjen;
- është ose në çfardo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimt ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i nje posti udhëheqës ose vendimmarrëes në një parti politike;
- ka çfardo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyr rutinore, me besnikëri, në mënyr të pavarur dhe objektive t'I përmbush detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.

**Kushtet per aplikim :**
**Kandidatet per antare te bordit te drejtoreve duhet ti dorezoj dokumentet e meposhtme:**

- Deshmin e kualifikimit profesional
- CV-në
- Letër motivimin
- Certifikatën(dëshmin) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose letërnjoftimit)
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim, me rastin e aplikimt, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësis dhe të përshtatshmëris profesionale.
Çdo përgënjeshtrim matrial, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshimi matrial nga informatat e dhëna në deklaratën e siperërmendur, do të rezultoj në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në zarf të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe të dorëzohen në Qendren per sherbim me qytetar në komunën e Hanit të Elezit.
Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.
Do të konktaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervist.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit nga popullata jo-shumicë dhe të interesuarit që do të përfaqësojn interesat e Komunës ku NP vepron, që të aplikojn në konkursin për drejtorë të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike .

Afati i konkursit është i hapur 15(pesëmbedhjet) ditë nga data e publikimit prej dt.19.03.2024 -02.04.2024

Komisioni Komunal I Aksionarëve:
Sevime Bajrami ____________
Sherif Berisha ____________
Xhevahir Dernjani ____________

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E HANIT TË ELEZIT - OPSTINA HANI ELEZIT - MUNICIPALITY HANI ELEZIT